

SIGKOS SH.A.

**Raporti i auditorit të pavarur dhe pasqyrat financiare për vitin e
përfunduar më 31 dhjetor 2023**

Përmbajtja	Faqe
Raporti i auditorit të pavarur	1-2
Pasqyra e fitimit apo humbjes dhe të ardhurave tjera gjithpërfshirëse	3
Pasqyra e pozicionit financiar	4
Pasqyra e ndryshimeve në ekuitet	5
Pasqyra e rrjedhës së parasë	6
Shënimet për pasqyrat financiare	7-49
Aneks A – Pasqyrat Plotësuese	

Raporti i Auditorit të Pavarur

Për Aksionarët e
Kompanisë së Sigurimeve Sigkos Sh.a.

Opinion

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të Kompanisë së Sigurimeve Sigkos Sh.a. ("Kompania"), të cilat përfshijnë pasqyrën e të pozicionit financiar më 31 dhjetor 2023, pasqyrën të ardhurave gjithëpërfshirëse, pasqyrën e ndryshimeve në ekuitet dhe pasqyrën e rrjedhës së parasë për vitin e përfunduar, si dhe shënimet për pasqyrat financiare, duke përfshirë një përmbledhje të politikave të rëndësishme të kontabilitetit.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare shoqëruese paraqesin në mënyrë të drejtë, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të Kompanisë më 31 dhjetor 2023, si dhe performancën e saj financiare dhe rrjedhën e parasë për vitin e përfunduar, në përputhje me politikat e kontabilitetit të shpalosura në shenimin 2.1.

Ne kemi kryer auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë të përshkruara në mënyrë më të detajuar në paragrafin e raportit tonë Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare. Ne jemi të pavarur nga Kompania në pajtim me kërkesat etike që janë të rëndësishme për auditimin tonë të pasqyrave financiare në Kosovë, dhe ne poashtu kemi përmbushur përgjegjësitë tona të tjera etike në përputhje me këto kërkesa dhe të Kodit të BSNEK-së. Ne besojmë që evidenca e auditimit që ne kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë.

Theksim i çështjes

Siç shpaloset në shenimin 21 të pasqyrave financiare shoqëruese, kapitali i aksionarëve të Kompanisë në librat e Kompanisë më 31 dhjetor 2023, është 3,519,796 euro (2022: 3,519,796 euro) dhe nuk është rakorduar me informacionin e biznesit të marrë nga Agjencia për Regjistrimin e Bizneseve të Kosovës, ku kapitali i aksionarëve është 3,406,850.00 euro. Opinioni ynë nuk është modifikuar në lidhje me këtë çështje.

Informata tjera

Menaxhmenti është përgjegjës për informatat tjera. Informatat tjera përfshijnë shtojcat plotësuese të cilat përfshijnë "Margjinën e solvencës" dhe "Pasuritë që mbulojnë detyrimet e sigurimeve". Opinioni ynë mbi pasqyrat financiare nuk mbulon edhe informatat tjera dhe ne nuk shprehim ndonjë formë sigurie apo konkluzioni mbi to. Në lidhje me auditimin tonë të pasqyrave financiare, përgjegjësia jonë është të lexojmë informatat tjera dhe duke vepruar kështu, të konsiderojmë nëse informatat tjera janë materialisht në kundërshtim me pasqyrat financiare ose njohuritë tona të marra gjatë auditimit ose në të kundërtën duket të jetë materialisht e keqdeklaruar. Nëse, bazuar në punën që kemi kryer, vijmë në përfundim se ekziston një anomali materiale e këtyre informatave tjera, neve na kërkohet t'a raportojmë atë fakt. Ne nuk kemi asgjë për të raportuar në këtë aspekt.

Çështje të tjera

Pasqyrat financiare të Kompanisë së Sigurimeve Sigkos më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022 janë audituar nga një auditor tjetër i cili ka shprehur një opinion të kualifikuar në raportin e tyre më 13 prill 2023, lidhur me provizionet e lejimeve të të arkëtueshmeve nga Byroja Kosovare e Sigurimit që është njohur në vitin 2022 në vend të periudhave të mëparshme kur ekzistonte evidenca objektive për lejim.

Përgjegjësitë e Menaxhmentit dhe të atyre të ngarkuar me qeverisjen për pasqyrat financiare

Menaxhmenti është përgjegjës për përgatitjen dhe prezentimin e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me politikat e kontabilitetit të shpalosura në shenimin 2.1, dhe për ato kontrole të brendshme, që konsiderohen të nevojshme nga menaxhmenti për të mundësuar përgatitjen e pasqyrave financiare pa anomali materiale të shkaktuara nga mashtrimi apo gabimi.

Gjatë përgatitjes së pasqyrave financiare, menaxhmenti është përgjegjës për të vlerësuar aftësinë e Kompanisë për të vazhduar se përmbushuri parimin e vijimësisë, duke shpalosur, nëse është e zbatueshme, çështjet që kanë të bëjnë me vijimësinë e biznesit dhe duke përdorur parimin kontabël të vijimësisë, përveç kur menaxhmenti ka për qëllim të likuidojë Kompaninë ose të ndërpresë aktivitetet, ose nuk ka ndonjë mundësi tjetër përveç se të veprojë në këtë mënyrë.

Personat që janë të ngarkuar me qeverisjen janë përgjegjës për mbikqyrjen e procesit të raportimit financiar të Kompanisë.

Përgjegjësia e Auditorit për auditimin e pasqyrave financiare

Qëllimet tona janë që të arrijmë një siguri të arsyeshme lidhur me faktin që pasqyrat financiare në terësi nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë si pasojë e mashtrimeve ashtu edhe e gabimeve, dhe lëshimin e një raporti auditimi i cili përmban opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë i sigurisë, por nuk është garancion i asaj që një auditim i kryer në përputhje me SNA-të, do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston. Anomalitë mund të lindin si rezultat i mashtrimeve ose gabimeve dhe konsiderohen materiale nëse individualisht, ose të bashkuara, mund të pritet në mënyrë të arsyeshme që të ndikojnë në vendimet ekonomike të shfrytëzuesve të pasqyrave financiare, të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

Si pjesë e auditimit në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykim profesional dhe ruajmë skepticism profesional gjatë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë riskun e anomalive materiale të pasqyrave financiare, si pasojë nga mashtrimet apo edhe si pasojë e gabimeve, dizajnojmë dhe kryejmë procedura të auditimit të cilat i përgjigjen këtyre risqeve dhe marrim evidencat të auditimit të cilat janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar një bazë për opinionin tonë. Risku i mos-zbulimit të një anomalie materiale e cila rrjedhë nga mashtrimi është më i madh sesa i atij që rrjedhë nga gabimi, pasi që mashtrimi mund të përfshijë marrëveshje të fshehta, falsifikime, lëshime të qëllimshme, keqinterpretime, ose shkelje të kontrollit të brendshëm.
- Sigurojmë një njohje të kontrollit të brendshëm, që është relevante me auditimin në mënyrë që të dizajnojmë procedurat e auditimit që janë të përshtatshme me rrethanat, mirëpo jo me qëllim për dhënien e një opinionimi mbi efektivitetin e kontrolleve të brendshme të Kompanisë.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave të kontabilitetit të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve kontabël si dhe shpalosjet e bëra nga menaxhmenti.
- Nxjerrim përfundime në lidhje me përshtatshmërinë e përdorimit të bazës së hipotezës së vijimësisë së kontabilitetit, duke u bazuar në evidencat e auditimit, nëse një pasiguri materiale ekziston në lidhje me ngjarjet ose kushtet që mund të shkaktojnë dyshim të lartë që Kompania mund të vazhdojë operimin. Nëse ne vijmë në përfundim se një pasiguri materiale ekziston, ne jemi të detyruar të tërheqim vëmendjen në raportin tonë të auditimit në shpalosjet e pasqyrave financiare ose nëse shpalosjet e tilla janë jo të përshtatshme, të modifikojmë opinionin tonë. Përfundimet tona janë të bazuara në evidencat tona të auditimit të siguruar deri në datën e raportit tonë. Sidoqoftë, ngjarjet ose kushtet e ardhshme mund të shkaktojnë që Kompania të ndërpresë së pëmbushuri parimin e vijimësisë.
- Vlerësojmë paraqitjen e përgjithshme, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare duke përfshirë informacionet shpjeguese të dhëna, dhe nëse pasqyrat financiare të prezentojnë transaksionet dhe ngjarjet në to në një mënyrë që arrin paraqitjen e drejtë.

Ne komunikojmë me ata që janë të ngarkuar me qeverisjen e Kompanisë së Sigurimeve Sigkos Sh.a., përpos të tjerave, lidhur me qëllimin dhe kohën e planifikuar të auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi të rëndësishme në kontrollet e brendshme që ne mund të identifikojmë gjatë auditimit.

Grant Thornton LLC
Prishtinë,
30 prill 2024


Suzana Stavrikj
Auditor ligjor



KOMPANIA E SIGURIMEVE SIGKOS SH.A.**Pasqyra e fitimit apo humbjes dhe të ardhurave tjera gjithëpërfshirëse****Për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2023**

		Për fund vitin 31 dhjetor 2023	Për fund vitin 31 dhjetor 2022
	Shënime	(në Euro)	(në Euro)
Primet bruto të shkruara	7	6,473,154	5,957,853
Primet e lëshuara ri-siguruesve		(258,663)	(545,996)
Neto primet e shkruara		6,214,491	5,411,857
Neto ndryshimi i rezervave për primet e pa fituara	24	(137,862)	(823,397)
Primi i fituar neto		6,076,629	4,588,460
Të ardhura nga Byroja e Sigurimit të Kosovës (BKS)	8	506,715	442,959
Të hyrat nga interesi	9	183,947	156,170
Të hyrat tjera	10	559,618	349,287
Të hyrat nga Komisionet e Risigurimit		-	155,549
Gjithsej të hyrat		7,326,909	5,692,425
Humbjet dhe shpenzimet e dëmeve pezull	22	(3,923,210)	(2,543,181)
Shpenzime për Byronë Kosovare të Sigurimeve(BKS)	8	(230,433)	(148,999)
(Ndryshimi) Rezerva për demet e raportuara (Pjesa e Risigurimit)	22	-	(808,799)
(Ndryshimi) Kostot e shtyera të marrjes në sigurim		133,867	51,758
Shpenzimet administrative	12	(2,591,890)	(3,585,214)
Gjithsej shpenzimet		(6,611,566)	(7,034,435)
Fitimi para tatimi		715,343	(1,342,010)
Tatimi në fitim	13	(217,327)	(80,113)
(Humbja) Fitimi Neto		498,016	(1,422,123)
Rivlerësimi i asetëve	18	149,888	-
Gjithsej të ardhurat gjithëpërfshirëse për vitin		647,904	(1,422,123)

Shënimet shoqëruese nga 1 deri 28 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare

KOMPANIA E SIGURIMEVE SIGKOS SH.A.**Pasqyra e pozicionit financiar****Më 31 dhjetor 2023**

		Më 31 dhjetor 2023	Më 31 dhjetor 2022
	Shënim	(në Euro)	(në Euro)
Pasuritë			
Paraja dhe ekuivalentët e parasë	14	170,956	117,675
Depozitat	15	9,705,652	8,105,205
Llogari të arkëtueshme nga sigurimi	16	211,917	469,228
Kosto e shtyrë e marrjes në sigurim	17	468,329	334,361
Pasuritë e risigurimit	23	55,639	87,067
Prona dhe pajisjet	18	1,837,352	1,870,866
Pasuritë e paprekshme	19	36,374	46,436
Pasuritë tjera afatshkurtra	20	1,069,967	729,713
Gjithsej pasuritë		13,556,186	11,760,551
Ekuiteti i aksionarëve dhe detyrimet			
Ekuiteti			
Kapitali aksionar	21	3,519,796	3,519,796
Rivlerësimi i rezervës		937,525	787,637
(Humbje)Fitim të akumuluar		346,457	(151,557)
Gjithsej ekuiteti i aksionarëve		4,803,778	4,155,876
Detyrimet			
Rezerva e dëmeve pezull	22	4,116,462	2,969,082
Rezerva e primit të pafituar	24	3,724,729	3,586,868
Llogaritë e pagueshme të sigurimit		62,733	46,196
Llogaritë tjera të pagueshme	25	848,484	1,002,529
Gjithsej detyrimet		8,752,408	7,604,675
Gjithsej detyrimet dhe ekuiteti i aksionarëve		13,556,186	11,760,551

Të aprovuara dhe lëshuara nga menaxhmenti dhe të nënshkuara në emër të tij më 30 prill 2024.



Drita Kadriu Berisha
Drejtoreshë e Përgjithshme



Aulona Sadiku
Drejtoreshë Financiare

Shënimet shoqëruese nga 1 deri 28 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare

KOMPANIA E SIGURIMEVE SIGKOS SH.A.**Pasqyra e ndryshimeve ne ekuitet****Më 31 dhjetor 2023**

	Kapitali Aksionar	Rezervat e rivlerësuara	Fitimi / Humbja e akumuluar	Gjithsej Ekuiteti
	(në Euro)	(në Euro)	(në Euro)	(në Euro)
Gjendja më 1 janar 2022	3,406,850	787,637	1,270,564	5,465,053
Shtim Kapitali	112,946	-	-	112,946
(Humbja)Fitimi i vitit 2022	-	-	(1,422,123)	(1,422,123)
Të ardhurat tjera gjithëpërfshirëse	-	-	-	-
Gjendja më 31 dhjetor 2022	3,519,796	787,637	(151,557)	4,155,876
Gjendja më 1 janar 2023	3,519,796	787,637	(151,557)	4,155,876
Shtim Kapitali	-	-	-	-
(Humbja)Fitimi i vitit 2023	-	-	498,016	498,016
Të ardhurat tjera gjithëpërfshirëse	-	149,888	-	149,888
Gjendja më 31 dhjetor 2023	3,519,796	937,525	346,457	4,803,778

Shënimet shoqëruese nga 1 deri 28 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare

KOMPANIA E SIGURIMEVE SIGKOS SH.A.**Pasqyra e rrjedhës së parasë****Për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2023**

	Shënim	Për fund vitin 31 dhjetor 2023 (në Euro)	Për fund vitin 31 dhjetor 2022 (në Euro)
Rrjedha e parasë nga aktivitetet operative			
Fitimi për vitin		498,016	(1,342,010)
<i>Rregullimet për vitin:</i>			
Zhvlerësimi dhe amortizimi	12	371,184	127,240
Ndryshimi nga shitja e aseteve		-	5,818
Ngarkesa nga zhvlerësimi i provizionit për te arketueshmet		223,947	(256,852)
Ngarkesa nga provizionimi i aseteve tjera		61,962	-
Të ardhurat nga interesit	9	(202,897)	(171,915)
Shpenzimet e interesit		18,950	15,745
		971,162	(1,621,974)
<i>Ndryshime në pasuritë operative</i>			
Të arkëtueshmet nga sigurimi		31,427	721,732
Kostot e shtyera të marrjes në sigurim		(133,967)	(51,758)
Pasuritë tjera afatshkurtra	20	(340,255)	786,959
		528,367	(165,041)
<i>Ndryshimet në detyrimet operative</i>			
Humbja në provizionimet e dëmeve pezull		1,147,380	527,188
Provizionimi për primet e pafituara		137,861	823,397
Të pagueshmet tjera dhe tregtare	25	(135,319)	508,287
Tatimi në fitim	25	(18,727)	(80,113)
Të pagueshmet e risigurimit		16,536	-
Paraja neto e përdorur nga aktivitetet operative		1,676,098	1,613,718
Rrjedha e parasë nga aktivitetet investuese			
Blerja e pronës dhe pajisjeve	18	(8,776)	(66,308)
Blerja e pasurive të paprekshme		-	(13,746)
Rritja e depozitave	15	(1,600,446)	(1,497,366)
Interesi i arkëtuar		187,839	156,170
Paraja e përdorur në aktivitetet investuese		(1,421,382)	(1,421,250)
Rrjedha e parasë nga aktivitetet financuese			
Pagesat e qirasë gjatë vitit	20.1	(201,436)	(286,104)
Shtimi i kapitalit		-	112,946
Paraja e (përdorur në) gjeneruar nga aktivitetet financuese		(201,436)	(173,158)
Rritja/zvogëlimi neto në para të gatshme dhe ekuivalentët e parasë		53,281	19,310
Paraja dhe ekuivalentët e parasë në fillim të vitit	14	117,675	98,365
Paraja dhe ekuivalentët e parasë në fund të vitit	14	170,956	117,675

Shënimet e shoqëruese nga 1 deri 28 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare